Në bazë të dispozitave përkufizuese të dhëna në nenet 18, 20 dhe 37 të Ligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës, është themeluar Instituti UPCO Cluster HUB (me tutje "Instituti). Organizimi i brendshëm i Institutit, me qëllim jofitimprurës, është i rregulluar në bazë të nenit 31, pika 2 të Ligjit nr. 06/L-043, dhe bazuar në nenin 5 të Statutit të Institutit UPCO Cluster, ku përcaktohet se organi më i lartë drejtues është Bordi Drejtues, i cili shpall:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Pozita: Drejtor/e i/e Institutit UPCO Cluster Prishtinë

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve

Mandati: Drejtori/ja zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve për mandatin prej 2 vjetëve

Vendi: Prishtinë

Kompensimi: Kompensimi i drejtorit do të bëhet konform politikave dhe procedurave të kompensimit të Institutit UPCO Cluster, në vlerë prej 1,000.00 Euro bruto për 6-mujorin e parë. Kompensimi për muajt në vijim do të vendoset në bazë të projekteve.

Instituti është bashkëthemeluar nga Universiteti i Prishtinës, Komuna e Prishtinës dhe Oda Ekonomike e Kosovës, me qellim të përmbushjes së vizionit të themeluesve për: Mbështetjen e qasjes inovative të strukturuar e të bazuar në parimin e spirales së trefishtë (*triple helix*): akademi-qeveri-biznes (kërkime dhe zhvillim), duke nxitur bashkëpunimin e strukturuar në mes të sektorit publik dhe privat; ndihmesës që arsimi i lartë të përmbushë misionin e tretë të universiteteve dhe t'u përgjigjet nevojave të tregut të punës si dhe do t'i kontribuojë rritjes ekonomike dhe zhvillimit të gjithmbarshëm shoqëror. Instituti është themeluar me fushëveprimtarinë e edukimit dhe trajnimit, shkencës, përkrahje të biznesit, zhvillim ekonomik si dhe ndërmarrësi sociale.

TË PËRGJITHSHME

Kandidati/ja për këtë vend të punës duhet të jetë person me integritet, i cili/e cila i plotëson kushtet e kualifikimit dhe kriteret e pavarësisë, posedon përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, si dhe i plotëson kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në organizatat joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe Ligjit të Punës 03/L-212.

PËRSHKRIMI I DETYRAVE TË PUNËS

- Udhëheq Institutin dhe e përfaqëson ligjërisht në të gjitha procedurat e nevojshme;
- Bën planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin menaxherial dhe financiar të Institutit;
- Harton dhe udhëheq realizimin e planit vjetor të Institutit, planit të buxhetit dhe planeve tjera strategjike, afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata, në pajtueshmëri me strategjitë zhvillimore të tij, statutin dhe aktet e brendshme të Institutit;
- Bën parashikimin financiar dhe strategjik të aktiviteteve të Institutit;
- Zhvillon, merr pjesë dhe udhëheq aplikimin në projekte nga Bashkimi Evropian dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë;
- Organizon, mbikëqyr dhe e përfaqëson Institutit në të gjitha aktivitetet promovuese;
- Merr pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues (pa të drejtë vote);
- Raporton në baza të rregullta mujore, çerekmujore, gjysmëvjetore dhe vjetore te Bordi Drejtues;
- I zbaton të gjitha vendimet e Bordit Drejtues;
- E zbaton rregulloren e punës dhe manualin financiar të Institutit;
- Rekruton, organizon me detyra dhe mbikëqyr punën e stafit;
- Inicion, zhvillon dhe mirëmban komunikim për bashkëpunime vendore, rajonale dhe ndërkombëtare;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligjet e zbatueshme, statutin dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes si dhe aktet tjera pozitive.

KUSHTET E KUALIFIKIMIT PROFESIONAL DHE PËRSHTATSHMËRISË

Kandidati/ja i cili/e cila synon pozitën e drejtorit/es të/së Institutit duhet t'i plotësojë këto kritere:

- Të ketë diplomë universitare në fushat ekonomike, juridike, teknike, sociale apo në fushat e tjera të ndërlidhura me aktivitetet, në të cilat vepron Instituti.
- Të ketë përvojë në menaxhim të instituteve apo organizmave të ngjashëm ose të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit - në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, banka, institute apo konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë, e cila ka të bëjë me veprimtarinë dhe qëllimet e Institutit.
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme organizative, menaxhuese dhe të komunikimit (verbal, të shkruar, digjital);

- Njohuria e gjuhës angleze është e domosdoshme;
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të merren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësojë kushtet e përshtatshmërisë, të parapara me ligjet në Republikën e Kosovës si dhe me normat tjera pozitive relevante.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Kandidatët për drejtor/e të Institutit duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Aplikacioni, së bashku me CV-në (jo më shumë se dy (2) faqe);
- Reflektim mbi konceptin triple-helix dhe cilat janë dy sfida të cilat mund të zgjidhen;
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional dhe përvojën;
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit.

INFORMATA PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT

Aplikacionet e kompletuara, me subjekt – Aplikim për pozitën e drejtorit, të dërgohen në adresën elektronike info@upcokosovo.com.

Konkursi është i hapur nga data 17.03.2023 deri më 07.04.2023, në orën 16:00. Aplikimet pas kësaj date nuk pranohen.

Shënim: Bordi i Drejtorëve do të zhvillojë një procedurë të hapur/transparente, ku përzgjedhja do të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës, konform ligjit në fuqi dhe pa asnjë lloj diskriminimi, për çka inkurajojmë në aplikim të gjithë kandidatët dhe nga të gjitha komunitetet e Republikës së Kosovës si dhe kandidatët nga të gjitha kategoritë tjera.